

BULETINI



KOMUNA E LIPJANIT
QERSHOR 2026

KRYETARI AHMETI PRITI NË TAKIM AMBASADOREN E FINLANDËS NË KOSOVË

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore në Grykën e Shalës, në nderim të 27-vjetorit të rënies së martirit Uran Amërllahu. Me këtë rast nënkryetari Bytyqi, theksoi se nderimi i martirëve dhe viktimave të luftës është detyrim i përhershëm i institucioneve dhe shoqërisë sonë. Historia e Uranit dhe e fëmijëve të tjerë të vrarë gjatë luftës duhet të mbetet pjesë e kujtesës sonë kolektive, si dëshmi e vuajtjeve dhe sakrificës së popullit të Kosovës në rrugëtimin drejt lirisë. Lavdi martirit Uran Amërllahu dhe të gjithë martirëve të lirisë!



DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, dhe me organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, u shënuar Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, duke sjellë një atmosferë festive dhe plot gjallëri në sheshin "Adem Jashari".

Fëmijë të shumtë morën pjesë në programin e organizuar me aktivitete të shumta për këtë ditë të veçantë, duke e shndërruar sheshin në një hapësirë të mbushur me gëzim, lojëra dhe buzëqeshje.

Urime 1 Qershori për të gjithë fëmijët!



NËNKRYETARI BYTYQI NDERON ME HOMAZHE HEROIN LULZIM LLUGIQI

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të Dëshmorit të Kombit, Lulzim Llugiqi, me rastin e 27-vjetorit të rënies së tij heroike.

Me këtë rast nënkryetari Bytyqi, theksoi rëndësinë e kontributit dhe sakrificës së dëshmorëve për lirinë e vendit, duke vlerësuar se ata janë themeli i lirisë dhe shtetit tonë. Ai veçoi figurën e Lulzim Llugiqit, i cili u kthye nga diaspora për t'iu bashkuar luftës çlirimtare, duke shtuar se vepra dhe sakrifika e tij, si dhe e të gjithë dëshmorëve, duhet të kujtohen dhe nderohen gjithmonë. Pas homazheve u mbajt një program përkujtimor kushtuar jetës dhe veprës së dëshmorit Lulzim Llugiqi, ku u përkujtua roli dhe sakrifika e tij në rrugën drejt lirisë.

Lavdi e përjetshme të gjithë atyre që ranë për lirinë e atdheut!



MBI 180 PROJEKTE U PREZANTUAN NË EDICIONIN E PESTË TË PANAIRIT P-GJASHT NË LIPJAN

Në kuadër të shënimit të Ditës së Shkollës në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, në palestrën sportive “Better Life” u mbajt edicioni i pestë i P-GJASHT, panairi i gjuhës, artit, shkencës dhe teknologjisë. Ky aktivitet edukativ është shndërruar në një ngjarje të rëndësishme për promovimin e kreativitetit, inovacionit dhe mendimit kritik të nxënësit.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, Drejtori i Arsimit z. Rasim Hasani, përfaqësues të institucioneve arsimore, mësimdhënës, prindër dhe nxënës.

Me këtë rast kryetari Ahmeti, vlerësoi rëndësinë e panairit, duke theksuar se ai tashmë ka tejkaluar kufijtë e Komunës së Lipjanit dhe është shndërruar në një model të suksesshëm të promovimit të dijes dhe kreativitetit.

“Panairi i Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë është një projekt që dëshmon potencialin dhe talentin e nxënësve tanë. Fakti që ky panair ka tejkaluar kufijtë e Komunës së Lipjanit dhe ka bashkuar shkolla nga komuna të ndryshme e bën atë një nga iniciativat më të rëndësishme arsimore që mbështesim me përkushtim. Ne do të vazhdojmë të mbështesim projekte që nxisin dijen, kreativitetin dhe inovacionin të gjeneratave të reja”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Drejtori i SHFMU “Vëllezërit Frashëri” z. Jakup Bahtri, falënderoi Kryetarin e Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë këtij organizimi ndër vite. Ai bëri të ditur se në edicionin e sivjetmë po prezantohen mbi 180 projekte nga nxënësit e shkollave të komunave të Lipjanit, Prishtinës, Podujevës dhe Drenasit, gjë që dëshmon për rritjen e vazhdueshme dhe rëndësinë që ka marrë ky panair në nivel ndërkomunal.

Në përmbyllje të aktivitetit, drejtori Bahtri ndau mirënjohje për Kryetarin z. Imri Ahmeti, dhe Drejtorin e Arsimit z. Rasim Hasani, në shenjë falënderimi për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributin e tyre në organizimin dhe zhvillimin e suksesshëm të Panairit P-GJASHT.



PANAIRI I PRODUKTEVE USHQIMORE DHE ARTIZANALE

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, ka marrë pjesë në Panairin e Produkteve Ushqimore dhe Artizanale, një aktivitet i dedikuar promovimit të prodhuesve vendorë dhe artizanëve lokalë, i cili do të zgjasë për dy ditë.

Panairi mbledhi prodhues dhe artizanë nga Komuna e Lipjanit, të cilët prezantuan produktet e tyre tradicionale, përfshirë produkte ushqimore vendore, punime artizanale dhe prodhime bujqësore, duke krijuar një platformë për prezantimin e punës dhe produkteve të tyre.

Ky aktivitet synon të mbështesë zhvillimin e prodhimit vendor dhe fuqizimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, si faktor kyç për zhvillimin ekonomik lokal, si dhe rritjen e potencialit prodhues të komunës së Lipjanit.

Panairi u organizua me mbështetjen e Komunës së Lipjanit dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.



KRYETARI AHMETI BËN HOMAZHE PRANË SHTATORES SË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI NË NDERIM TË DITËS SË ÇLIRIMIT

Me rastin e 12 Qershorit Ditës së Çlirimit, Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari.

Me këtë rast kryetari Ahmeti, theksoi se 12 Qershori përbën një nga datat më të rëndësishme në historinë tonë më të re.

“Në këtë 27-vjetor të çlirimit, përulemi me respekt para veprës dhe sakrificës së atyre që dhanë gjithçka për lirinë e vendit. 12 Qershori mbetet një datë me rëndësi të veçantë historike, që na obligon të kujtojmë dhe të nderojmë përherë heronjtë dhe dëshmorët që flijuan jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit dhe heronjve të lirisë!

Urime 12 Qershori Dita e Çlirimit!




KONCERT FESTIV NË NDER TË DITËS SË ÇLIRIMIT TË LIPJANIT

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit, në sheshin “Adem Jashari” u mbajt koncert festiv, i cili mbledhi qytetarë të shumtë në një atmosferë festive.

Me performancat e Alban Mehmetit, Bajram Jakajt, Erjad Karpuzit & Rilind Krasniqit, Ajla Jakajt dhe DJ Ami u krijua një mbrëmje e mrekullueshme.

Urime Dita e Çlirimit!



AKADEMI PËRKUJTIMORE NË NDERIM TË DËSHMORËVE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Me rastin e 14 Qershorit Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit, nën patronatin e Kryetarit të Komunës z. Imri Ahmeti, në Sallën e Kuvendit u mbajt Akademia Përkujtimore kushtuar dëshmorëve, në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për sakrificën e tyre për lirinë e Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve përkujtimore, paraprakisht u bënë homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, ku familjarë të dëshmorëve, bashkëluftëtarë, përfaqësues institucionalë dhe qytetarë nderuan me respekt veprën dhe sakrificën e bijve dhe bijave të Lipjanit.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, theksoi se 14 Qershori zë një vend të veçantë në historinë dhe kujtesën kolektive të Lipjanit, duke nderuar sakrificën e dëshmorëve që u rreshtuan në anën e lirisë dhe u bënë pjesë e përrjetshme e historisë sonë kombëtare.

“Liria e Kosovës nuk erdhi rastësisht, por u ndërtua mbi gjakun e dëshmorëve, luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbështetjen e aleatëve ndërkombëtarë. Kujtimi për dëshmorët obligon secilin qytetar dhe institucion që të mos harrojë kurrë rrugën që na solli lirinë”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai theksoi gjithashtu se vlerat për të cilat u flijuan dëshmorët duhet të ruhen dhe të respektohen vazhdimisht, pa u përdorur për interesa të ngushta politike apo personale.



KOMITETI PËR KOMUNITETE KA ZHVILLUAR PUNIMET E MBLEDHJES SË 5-TË ME RADHË



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 5-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi z. Alush Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete prezantuan raportin e punës së ZKK-së.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme të paraqitura nga komunitetet.

KRYETARI AHMETI NDERON ME HOMAZHE DËSHMORIN IBRAHIM KRASNIQI

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë bustit dhe varrit të dëshmorit Ibrahim Krasniqi në fshatin Smallushë, në nderim të përvjetorit të rënies së tij.

Me këtë rast kryetari Ahmeti, theksoi se dëshmorët e kombit mbeten simbol i sakrificës dhe përkushtimit për lirinë e vendit. Nderimi dhe kujtimi i veprës së tyre është një përgjegjësi e vazhdueshme për institucionet dhe qytetarët, ndërsa idealet për të cilat ata dhanë jetën na obligojnë të punojmë për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të zhvilluar.

Lavdi e përjetshme për të gjithë ata që ranë për liri!



SHËNOHET 100-VJETORI I THEMELIMIT TË SHFMU “ZENEL HAJDINI” NË GADIME

Me një program të pasur artistik, u shënua 100-vjetori i themelimit të SHFMU “Zenel Hajdini” në Gadime, një jubile i rëndësishëm që përfaqëson një shekull përkushtimi në arsimimin dhe edukimin e brezave të tërë.

Në këtë aktivitet morën pjesë Nënkyetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, Drejtori i Arsimit z. Rasim Hasani, përfaqësues të institucioneve, mësimdhënës, ish-punëtorë të arsimit, nxënës dhe qytetarë të shumtë.

Me këtë rast nënkryetari Bytyqi, uroi përfaqësuesit e shkollës për këtë përvjetor të rëndësishëm, duke vlerësuar lart rolin dhe kontributin e gjeneratave të tëra të mësimdhënësve në zhvillimin e arsimit.

“Përkushtimi, sakrificat dhe puna e palodhshme e shumë gjeneratave të mësuesve dhe profesorëve kanë bërë që drita e dijes të mbetet e ndezur ndër dekada. Sot në këtë 100-vjetor me respekt dhe mirënjohje kujtojmë të gjithë ata mësimdhënës që dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në edukimin dhe formimin e brezave të shumtë, duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor edhe në periudhat më sfiduese”, tha nënkryetari z. Diamant Bytyqi.



LIPJANI VLERËSOHET ME ÇMIMIN E MIRËNJOHJES NË FESTIVALIN FOLKLORIK TIPOLOGJIK KOMBËTAR

Komuna e Lipjanit u nderua me Çmimin e Mirënjohjes në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar, i mbajtur në Leskovik të Ersekës, Shqipëri, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Muzikës.

Me mbështetjen e Komunës së Lipjanit, qyteti ynë u përfaqësua në këtë festival nga folkloristët Erjad Korpuzi dhe Rilind Krasniqi, të cilët prezantuan vlerat e traditës, kulturës dhe trashëgimisë folklorike të Lipjanit dhe Kosovës.

Çmimi i Mirënjohjes i ndarë nga organizatorët e festivalit përbën një vlerësim të rëndësishëm për promovimin e kulturës sonë dhe përfaqësimin e suksesshëm të vlerave folklorike.



TAKIM DISKUTUES PËR ADRESIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE PËRMES TEKNOLOGJISË

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Rrjetit të Grave të Kosovës, është mbajtur takim diskutues me anëtarët e Mekanizmit Koordinues Lokal Kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore.

Gjatë takimit u diskutua për format e dhunës me bazë gjinore të kryer përmes teknologjisë, përdorimin e provave digjitale në trajtimin e rasteve, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstytucional për parandalimin dhe adresimin e këtyre dukurive.



FILLOJNË DËGJIMET BUXHETORE PËR HARTIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2027–2029

Komuna e Lipjanit ka filluar procesin e dëgjimeve buxhetore me qëllim të hartimit sa më gjithëpërfshirës të Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2027–2029.

Në hapje të dëgjimeve drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, prezantoi rëndësinë e këtij procesi dhe rolin e dëgjimeve publike në planifikimin e buxhetit komunal, duke theksuar se pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe akterëve të ndryshëm kontribuon në përcaktimin e prioritetëve zhvillimore dhe investimeve për vitet e ardhshme.

Dëgjimet e para u mbajtën me pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe komiteteve të tjera komunale, përfaqësuesve dhe shoqatave të grave, organizatave të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe shoqatave rinore, klubeve sportive, si dhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe të Grackës së Vjetër. Përmes këtij procesi synohet sigurimi i një planifikimi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës, duke krijuar mundësi që kërkesat dhe propozimet e qytetarëve të përfshihen në dokumentet strategjike financiare të komunës.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar ndaj transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse, me qëllim të avancimit të zhvillimit të qëndrueshëm.



KRYETARI AHMETI MBAJTI TAKIM PUBLIK ME QYTETARËT

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit ka mbajtur takim publik me qytetarët, me qëllim të prezantimit të punëve të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, si dhe për të dëgjuar nga afër kërkesat dhe propozimet e tyre lidhur me investimet dhe zhvillimin e komunës.

Gjatë takimit Kryetari Ahmeti, prezantoi realizimin e të hyrave vetanake, ku deri më tani është realizuar 48.32% e planifikimit vjetor. Veçanërisht u theksua realizimi i tatimit në pronë i cili ka arritur në 32.22%.

“Sa u përket projekteve kapitale, aktualisht janë në proces disa projekte, ku një pjesë e tyre është duke u zbatuar në terren, ndërsa të tjerat ndodhen në fazat e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, me pritshmëri që shumë shpejt të fillojnë punimet”, tha Kryetari, z. Imri Ahmeti.

Gjithashtu ai theksoi se përveç investimeve në infrastrukturë, prioritet i veçantë do t’u kushtohet edhe sektorëve të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, sportit, kulturës dhe rinisë, për të cilët janë realizuar projekte të rëndësishme dhe janë ndarë subvencione. Mbështetja për këta sektorë do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Qytetarët e pranishëm në takim shprehën mirënjohje për angazhimin e Kryetarit Ahmeti dhe kabinetit të tij në realizimin e projekteve të shumta. Ata gjithashtu paraqitën kërkesa për investime në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më me prioritet për ta.

Në përmbyllje të takimit Kryetari Ahmeti, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e një qeverisjeje të hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente, në shërbim të qytetarëve.



KPF MBAN MBLEDHJEN E 5-TË ME RADHË



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 5-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.

Gjatë këtij takimi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka prezantuar pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të martën, më 30 qershor 2026.

MBAHET MBLEDHJA E DYTË E KKSBB-SË PËR VITIN 2026

Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e dytë për vitin 2026 e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), në të cilën u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunë dhe çështje të tjera me interes për sigurinë publike.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit dhe njëherësh kryesues i KKSBB-së, z. Diamant Bytyqi, në fjalën hyrëse përshëndeti anëtarët e Këshillit dhe foli për situatën e përgjithshme të sigurisë publike në komunë.

Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të aktiviteteve që ndikojnë në rritjen e vetëdijes së qytetarëve për çështjet që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm. Shefi i Operatives në Stacionit Policor në Lipjan, z. Fehmi Haxholli, prezantoi pasqyrën e përgjithshme të gjendjes së sigurisë në komunë, duke vlerësuar se situata vazhdon të jetë e qetë dhe stabile.

Ai gjithashtu informoi anëtarët e Këshillit lidhur me rastin e fundit të ndodhur në fshatin Magurë, si dhe falënderoi institucionet komunale për bashkëpunimin dhe koordinimin e vazhdueshëm në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Në këtë mbledhje, udhëheqësi i Njësisë së Zjarrfikësve në Lipjan, z. Sadri Shamolli, prezantoi raportin mbi intervenimet e realizuara gjatë kësaj periudhe.



U MBAJT MBLEDHJA E 7-TË ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 7-të me radhë, në të cilën u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të propozuara për këtë seancë. Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508